

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - gjyqtar Naim Kurtishi, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në çështjen juridike të paditësit KEK - Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson Ylgere Mati nga Prizreni, kundër të paditurit Sh. H. D. nga fsh. Korishë, Komuna e Prizrenit, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 3.039.72 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.08.05.2014 morri këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit KEK-Distrikti në Prizren, **si e bazuar.**
- II. OBLIGOHET** –i padituri Sh. D. nga fsh. K., Komuna e Prizrenit, që në emër të borxhit për harxhimin e energjisë elektrike ta paguajë paditësit shumën prej 3.039,72€, me kamat ligjore nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale në shumën prej 20.50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

E autorizuar e paditësit, gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi pranë pohimeve në padi dhe kërkesëpadi, duke i propozuar Gjykatës që pas vlerësimit të provave të administruara të njëjtën të aprovoi në tërësi si të bazuar, dhe të paditurin Sh. H. D. ta obligojë që paditësit ta paguajë borxhin në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike të kërkuar në padi, me kamata ligjore nga dita e paraqitjes së kërkesës në gjykatë, si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale për taksën gjyqësore në shumën prej 20.50 euro.

I padituri Sh. D., në shqyrtimin kryesor ngel në tërësi në të dhënat e paraqitura me shkrim në kundërshtimin e deponuar në gjykatë, duke sqaruar se në fshat ju është djegur punëtorja në të cilën ka punuar, për të cilën edhe ngarkohet me borxhin, duke potencuar se ai këtë punëtor nuk e shfrytëzon fare, por duke sqaruar se në vitin 2004 palës paditëse i ka paguar 1000 euro në emër të harxhimit të rrymës elektrike duke lidhur edhe kontratë me palën paditëse për të riprogramuar borxhin e mbetur prej 2000 euro. Mirëpo, deklaroi se më vonë nuk ka pasur mundësi për të vazhduar pagesën e këtij borxhi, ka paguar në shuma të vogla me nga 100 euro e më pak, pasi që është në gjendje të vështirë ekonomike për të paguar borxhin, është ushqyes i 9 anëtareve të familjes, është veteran i luftës, andaj kërkon që edhe të lirohet nga pagimi i këtij borxhi.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: bëhet shiqimi i faturës DPZ 9006232 e lëshuar nga pala paditëse e në emër të paditurit, bëhet shiqimi në specifikacionin e faturave për vitin 2007- 2008 lidhur me harxhimet e bëra nga pala e paditur në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerrura në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me

kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Pas analizimit të provave të lartcekura dhe pohimit të paditurit në shqyrtimin kryesor gjykata ka vërtetuar se i padituri i ka borxh paditësit në vlerë prej 3.039,72€ për harxhimin e energjisë elektrike, i cili borxh del nga pohimi i vet paditësit në shqyrtimin kryesor për borxhin e pa paguar por edhe nga provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës, e që është konstatuar gjatë procedimit të kësaj çështje civile në shqyrtimin kryesor si nga fatura e paditësit DPZ – 9006232, specifikimi i faturave për vitin 2007 – 2008 lidhur me harxhimin e bërë të rrymës elektrike dhe shumat e obliguar për pagesën në emër të shfrytëzimit të rrymës elektrike.

Me nenin 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) – PR.Nr. 690, në kuptim të cilit është paraparë se **“pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”**, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se **“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”**,.

Kurse pretendimet e të paditurit se nuk ka mundësi për të paguar borxhin, pasi që është në gjendje të vështirë ekonomike dhe se është veteran i luftës bazuar në faktet dhe provat e administruara në rastin konkret janë të pa bazuara dhe nuk e arsyetojnë pretendimet e të paditurit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marr konform nenit 452.1 të LPK-së.

Andaj nga të lartcekurat si më lartë bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së, e lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.301/12, datë 08.05.2014

Bashkëpunëtori profesional,
Arlind Sharani

Gjyqtari,
Naim Kurtishi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.